VENDIM
Nr.45, datë 20.1.1997

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË UZINËS SË PLEHRAVE AZOTIKE NË FIER

Me propozimin e Ministrisë së Privatizimeve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të bëhet mbështetje financiare për uzinën e plehrave azotike në Fier, për shpenzime të mbartura nga viti 1996, në masën 6.8 milionë lekë që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për tremujorin e parë të vitit 1997.

Këto fonde të rikthehen në Buxhetin e Shtetit nga ana e uzinës së plehrave azotike në Fier brenda vitit 1997.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Privatizimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi